URDHËR
Nr. 355, datë 16.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 267, DATË 24.7.2019 "MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E KATEGORIZIMIT TË STRUKTURAVE AKOMODUESE"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 267, datë 24.7.2019, "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", bëhen ndryshimet si vijojnë:

1. Pika 4 ndryshon me përmbajtje, si më poshtë:

"4. Çdo subjekt që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese është i detyruar të aplikojë për marrjen e certifikatës së kategorizimit, brenda datës 31.12.2019, për të përfituar shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese".

2. Paragrafi i dytë i pikës 1, të nenit 5, të rregullores bashkëlidhur urdhrit, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

"Formulari i vetëdeklarimit shkarkohet nga faqja zyrtare e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit: turizmi.gov.al, në menunë "Turizmi/Udhëzues për qytetarët".".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi